



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat
dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Nr. 30
Prishtinë, më 17.03.2010, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Petar Miletic, Sanije Aliaj, Dragiša Mirić, Enis Kervan, Mursel Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha, Hetem Arifi, Sadik Idriz, Hafize Hajdini dhe Zafir Berisha.

Munguan: Müfera Şinik dhe Xhevdet Neziraj.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga Ambasada Zviceriane - Projekti për ndërtimin e paqes, mbikëqyrës nga Zyra e Presidentit, OSCE-së, KDI – së.

Nga Stafi Mbështetës: Natasa Prica, Vilson Ukaj dhe Dashurie Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Petar Miletic, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 18.02.2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me amendamente,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri, me amendamente,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësinë ligjore, me raportin e Komisionit funksional-Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimet postare, me raportin e Komisionit funksional-Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente,

7. Shqyrtimi i Projektligji për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare nr.03/L-183 e raportin e Komisionit funksional- Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente,
8. Shqyrtimi i raportit nga vizita studimore në Zvicër,
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar më 18. 02. 2010

Kryesuesi konstatoi procesverbali nga mbledhjes e kaluar, mbajtur më dt. 20. 02. 2010, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Arsimit, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me amendamente

Kryesuesi kërkoi nga anëtarët të deklarohej lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Enis Kervan theksoi se si anëtar i komisionit funksional ka kërkuar që neni 12 i projektligjit të plotësohet dhe të parashihet që tekstet mësimore përveç që duhet siguruar në gjuhët zyrtare, ato të jenë edhe në gjuhët e komunitetit turk, boshnjak dhe në të ardhmen edhe të komunitetit rom. Komisioni funksional nuk e ka përkrahur propozimin tim, për çka edhe kam votuar kundër miratimit të projektligjet. Nëse nuk plotësohet ky nen edhe në këtë komision, prapë do të votojë kundër.

Sanije Aliaj theksoi se kërkesa e bëra nga z. Kervan është pranueshme dhe konform ligjeve në fuqi, në bazë të së cilave Ministria e Arsimit duhet sigurojë tekste për të gjitha komunitetet në gjuhët e tyre amtare. Tekstet duhet të shtypen në Kosovë dhe mësimi duhet të bëhet në bazë të planprogramit të Ministrisë së Arsimit të Qeverisë së Kosovës.

Sadik Idriz vlerësoi propozimin e z. Kervan në pajtim me ligjet në fuqi dhe theksoi se duhet të jetë i realizueshëm. Ministria e Arsimit duhet të sigurojë tekste edhe për komunitetet tjera, si turk, boshnjak, rom, dhe ato tekste duhet të shtypen në Kosovë.

Zylfi Merxha mbështeti propozimin e z. Kervan dhe kërkoi që të plotësohet kjo zbrazëti juridike dhe më pas Ministria të veprojë në interes të të gjithë komuniteteve.

Numan Balić gjithashtu shprehu mendimin se çështje sigurimi i teksteve për gjuhët e komuniteteve tjera duhet rregulluar me ligj, dhe në këtë formë do shmangej çfarëdo mundësie për manipulim.

Zafir Berisha theksoi se në bazë të ligjeve në fuqi, komisioni ynë mund ta bëjë propozimin për plotësimin e nenit dhe ky propozim ti dërgohet komisionit funksional.

Kryesuesi nënvizoi se nga diskutimet shifet se askush nuk është kundër propozimit të z. Kervan. Po ashtu nga diskutimet doli propozimi që të ftohet Ministri i Arsimit, për të diskutuar për këtë çështje dhe çështjet e natyrës së këtillë.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Mërgatën e Kosovës raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Vërejtje konkrete

Neni 12, në vazhdim të paragrafeve 1,2, 3 dhe 6.1 shtohet teksti si vijon:

“dhe në gjuhët e komuniteteve tjera në të cilat zhvillohet sistemi arsimor në Kosovë”

Arsyetim:

Komisioni konstatoi dhe vlerësoi se amendamenti i propozuar ka për qëllim respektimin e të drejtave të të gjithë komuniteteve, në krijimin e kushteve për mësim dhe ruajtjen e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve të përfaqësuesve të komuniteteve tjera në diasporë sipas kërkesës tyre, si dhe bashkëpunimin me institucionet e Republikës së Kosovës.

- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me raportin e Komisionit funksional - Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri, me amendamente**

Kryesuesi theksoi se ka lexuar projektligjin, i cili përveç disa vërejtjeve teknike që janë përmissuar me amendamentet e komisionit funksional nuk përmban ndonjë dispozitë që shkel të drejtat e komuniteteve dhe si i tillë është në interes të gjithëve. Kërkoj nga anëtarët tjerë të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme e Siguri, dhe ka konstatuar nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësinë ligjore, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente

Kryesuesi kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për mjekësinë ligjore dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe ka konstatuar nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbimet postare, me raportin e Komisionit funksional- Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente,

Kryesuesi kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimet postare dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, dhe ka konstatuar nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

7. Shqyrtimi i Projektligji për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare nr.03/L-183 e raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente

Kryesuesi kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar

Projektligjin për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Jashtme, dhe ka konstatuar nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtimi i raportit nga vizita studimore në Zvicër

Sanije Aliaj shprehu falënderimet institucioneve të Zvicrës, Ambasadës Zviceriane-Projekti për ndërtimin e paqes, , organizatës KONVIVENCA, për vizitën e nivelit shumë të lartë dhe mirëpritjen e bërë komisionit dhe vlerësoj ndër vizitat më të organizuara që kam realizua deri më tani. Sa i përket raportit, vërejtja e parë ka të bëjë me hartimin vonuar të tij. Raporti si i tillë është i mangët, ai prezanton vetëm opinionet e përfaqësuesve të institucioneve zviceriane dhe asgjë nuk prezanton nga opinionet e anëtarëve të komisionit dhe përvojat e vendit tonë. Raportit i mungojnë rekomandimet që kanë dalur nga përmbyllja e vizitës, qoftë për barazinë e gjuhëve apo edhe për përdorimin e teksteve shkollore, si dhe rekomandimi që përvojat e fituara atje të na shërbejnë për ndërtimin e shtetit tonë me pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve. Prandaj njoftoi se ka përgatitur me shkrim opinionet e saja që ka shprehur atje dhe disa rekomandime që duhet të jenë pjesë e këtij raporti.

Numan Balic duke komentuar raportin theksoi se ai për nga forma më shumë i ngjan procesverbalit se sa raportit. Ndërsa për nga përmbajta po ashtu është shumë i mangët. Mungojnë gjysma e deklaratave të pjesëmarrësve, mungon propozimi për zgjidhjen e problemeve. Kontribut kanë dhënë edhe përfaqësuesit e komuniteteve tjera dhe nuk janë përfshirë opinionet e tyre për çështjet e përdorimit të gjuhës, administrimi shumë gjuhësor dhe bartja e përvojave në Kosovë. Mungon përfundimi me rekomandime. Njëri ndër ato ishte që Qeveria e Zvicrës të ketë takime të rregullta me komisionin dhe të shikohet mundësia e shkëmbimit të përvojave dhe përfutimit të ndihmës së tyre. Raporti duhet plotësuar që të ketë përmbajtjen, qëllimin dhe përfundimin e vet, me propozime dhe rekomandimet konkrete.

Sadik Idriz theksoi se për këtë vizitë do të duhej të hartohej një shënim zyrtar dhe jo procesverbal apo raport. Pjesë e këtij shënimi nuk mund të jetë gjithçka që është diskutuar atje. Duhet pasqyruar informacionet më të rëndësishme.

Enis Kervan theksoi se kemi premtuar se do të përgatisim një raport dhe atë duhet ta bëjmë. Do të vazhdojmë kontaktet me Ambasadën Zviceriane. Pajtohem me disa propozime të znj. Aliaj, por se duhet përdorur termi komunitet dhe jo minoritet. Gjithashtu numri i mërgimtarëve që jetojnë në Zvicër përmendur i nga autoritetet zviceriane janë kosovar dhe jo shqiptar siq është shkruara. Si shkëmbim të përvojave nuk mund të marrim sistemin e arsimit zviceran sepse kemi dallime të mëdha me sistemin tonë funksionon ndryshe atje.

Zafir Berisha edhe pse nuk ka mundur të marrë pjesë në këtë vizitë, theksoi se e ka mbështetur atë. Nga përvoja ime në vizita të këtilla me komisione tjera, në çështjen e përgatitjes së raportit, theksoi se mjafton që të përgatitet një informatë e shkurtër për Kryesinë e Kuvendit dhe një kopje e saj të dorëzohet Ambasadës Zviceriane. Ndërsa nga përvojat e juaja të fituara atje, mund të jepni kontributin tuaj në qeshtje dhe në fusha të ndryshme në Kosovë.

Mursel Haljilji vlerësoi edhe njëherë lartë vizitën e realizuar në Zvicër për çka vlenë që të kemi një dokument të shkruar për atë vizitë. Propozoi që të ketë një shënim zyrtar dhe të jepen disa ide për mundësinë e shkëmbimit dhe zbatimit të përvojave të shtetit zviceran në vendin tonë, në fusha të ndryshme.

Kryesuesi theksoi se edhe pse nuk ka qenë në atë vizitë, mendon se pjesë e raportit duhet të jenë ato çka keni parë atje. Ndoshta mund të jetë një shënim zyrtar me përmbajtje. Ata që nuk janë të kënaqur mund ta bëjnë një raport për media. Prandaj shifet nevoja e plotësimit të tij dhe si rezultat propozoi që miratimi i tij të shtyhet për në mbledhjen tjetër të komisionit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Raporti nga vizita studimore në Zvicër shtyhet për në mbledhjen tjetër të Komisionit. Stafii mbështetës i punës së komisionit duhet plotësojë atë në bazë të kriterëve që duhet përmbaj raportit për vizitat jashtë vendit.

9. Të ndryshme

Kryesuesi njoftoi se në mbledhjen në mes Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve është kritikuar zvarritja e punëve që po bënë t komisioni në procedimin e projektligjeve, në veçanti për zvarritjen e procedimit të projektligjit për shitjen e banesave.

Numan Balić lidhur me projektligjin për shitjen e banesave njoftoi se kemi kërkuar që Kryesia të na sigurojë ekspert për të ndihmuar në shqyrtimin e tij dhe ata nuk e kanë marrë parasysh këtë kërkesë. Prandaj edhe duhet pritur deri sa të përfundohet puna me ndihmën e ekspertëve të siguruar nga jashtë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Petar Miletić